




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipal Assambly
01-Nr.464/01-39427/2019
Kaçanik,më 05.10.2020

Në bazë të dispozitave të nenit 4 dhe 11,të Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme të Republikës së Kosovës.Ligji Nr.03/ L-139 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme,Ligji Nr.03/L205 dhe nenit 11,82.103,107 dhe 109 të Ligjit për procedurën administrative,Nr.02/L-28 si dhe nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-40,,mbrenda afatit ligjor,Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET Shpronësimi për rregullimin-ndërtimin e rrugës "Hamzë Jashari" në fshatin Nikaj, për arritjen e qëllimit dhe përfitimit të ligjshëm publik sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01-Nr.941/01-34158/19 i datës 31.10.2019 me të cilin është shpall interes i përgjithshëm për shpronësimin e pjesëve të parcelave kadastrale si vijon:

1.Parcela kadastrale nr.00947-1 ,me kulturë kullosë e kl.3,në sipërfaqe prej 178 m2, Z.K Nikaj, në emër të Shaip (Rushit) Krasniqi nga Kaçaniku.

II.Obligohet Drejtoria për urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që brenda 5 ditëve të punës të Ju dërgoj vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në këtë Vendim.

III.Pjesë e këtij Vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompenzimit për ata pronar apo zotruar të interesit,të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i Shpronësimit.

IV.Shumën e kompenzimit për shpronësim sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e pronës së palujtshme nga Departmenti i Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës,Komuna e Kaçanikut do të paguaj në bazë të nenit 16 të Ligjit për Shpronësim e pronës së palujtshme të Republikës së Kosovës,pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

V. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi,do të paguhet në tërësi shuma e kompenzimit për pronën e shpronësuar me këtë vendim.

VI.Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar,Drejtoria për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e shpallë Vendimin Përfundimtar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

VII.Për zbatimin e këtij vendimi Obligohet Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VIII.Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit në njërin nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi,pala e paknaqur ka të drejtë ankese mbrenda 30 ditëve, pas hyrjes ne fuqi të këtij vendimi, në Gjykatë Themelore Ferizaj-dega në Kaçanik ,çdo person i cili është pronar ose zotrues i interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekuar nga Vendimi Përfundimtar dhe ate vetëm për kundërshtimin e shumës së kompenzimit.Mbrenda 5 ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës,parashtruesi i ankesës duhet të siguroi që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrën Ligjore të Shpronësimit të organit Shpronësues-Komuna e Kaçanikut,si dhe do të zbatohen dispozitat ligjore respektivisht nenet 36 dhe 37 të Ligjit për Shpronësim e pronës së palujtshme të republikës së Kosovës Nr.03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205.

Vendimi i dërgohet:

- 1.Drejtorisë për urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- 2.Poseduesit juridik-zotruesit të interesit të pronës,
- 3.Gazetës zyrtare të Kosovës dhe një gazete ditore me tirazh më të madh.
- 4.Arkivit .

Organi Shpronësues
Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

